Tetor 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

dppi
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSIË INDUSTRIALE



DPPI përmbush piketat përmbyllëse për Kapitullin 7

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) ka përmbushur piketat përmbyllëse të përcaktuara për Kapitullin 7 – "E Drejta e Pronësisë Intelektuale", në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE).
Me hapjen e negociatave, procesi kaloi nga shqyrtimi analitik i legjislacionit të BE-së (acquis) dhe përgatitja e Pozicionit Negociues në fazën e përmbushjes së kërkesave konkrete për mbylljen provizore të kapitullit.

Nëpërmjet Pozicionit të Përbashkët të Bashkimit Evropian për Grupkapitullin 2, u përcaktuan piketat përmbyllëse (Closing Benchmarks) për Kapitullin 7, të cilat udhëhoqën punën e mëtejshme të DPPI-së dhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Në këtë proces, DPPI ka luajtur rolin e Sekretariatit.

Pikat kryesore të përmbushura lidhen me:

1. Zbatimin e parimit të shterimit të të drejtave në nivelin e BE-së/Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE).

2. Përafrimin e legjislacionit me acquis-në e BE-së në fushën e pronësisë intelektuale.

3. Forcimin e kapaciteteve administrative dhe garantimin e zbatimit efektiv të të drejtave të pronësisë intelektuale.
Përmbushja e këtyre piketave përbën një hap të rëndësishëm në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë dhe dëshmon angazhimin e DPPI-së dhe të institucioneve përgjegjëse për avancimin e reformave në fushën e pronësisë intelektuale, në përputhje me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Tetor 2026

FORCOHET BASHKËPUNIMI ME WIPO-N NË MBËSHTETJE TË PRONËSISË INTELEKTUALE DHE INOVACIONIT NË SHQIPËRI



Në kuadër të zhvillimit të "Regional IP Youth Camp" në Shkodër, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithëshme të Pronësisë Industriale (DPPI), znj. Maria Solis Kapedani, së bashku me Zëvendësministrin e Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Martin Kajo, zhvilluan një takim bilateral me përfaqësuesin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), z. Habip Asan.

Në fokus të takimit ishte forcimi i bashkëpunimit ndërmjet DPPI-së dhe WIPO-s, me vëmendje të veçantë ndaj mbështetjes për Shqipërinë në hartimin e strategjive kombëtare, asistencës ligjore dhe teknike, si dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në fushën e pronësisë intelektuale.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edukimit dhe ndërgjegjësimit të të rinjve mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale, si dhe organizimit të "Regional IP Youth Camp" në Shkodër, një nismë që synon të nxisë kreativitetin, inovacionin dhe sipërmarrjen tek të rinjtë e Ballkanit Perëndimor.
Gjatë takimit, u rikonfirmua angazhimi për vijimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, në funksion të zhvillimit të sistemit të pronësisë intelektuale, procesit të integrimit evropian dhe krijimit të mundësive të reja për inovacionin dhe sipërmarrjen në Shqipëri.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Shkodra mirëpret “Regional IP Youth Camp 2026”



Tetor 2026









Shkodër, 5–8 tetor 2026 – Shkodra mirëpriti për katër ditë të rinj nga vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të aktivitetit Regional IP Youth Camp on Creativity, Innovation, and Entrepreneurship, me fokus promovimin e kreativitetit, inovacionit, sipërmarrjes dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale.
Aktiviteti u zhvillua në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër dhe u organizua nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) të Shqipërisë dhe institucionet homologe të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut.

Gjatë kampit, pjesëmarrësit shkëmbyen njohuri dhe përvoja mbi mbrojtjen e pronësisë intelektuale, zhvillimin e ideve inovative dhe shndërrimin e krijimtarisë në mundësi konkrete sipërmarrjeje. Në aktivitet morën pjesë edhe të rinj nga universitete dhe institucione arsimore shqiptare, përfshirë Universitetin “Fan S. Noli”, Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Universitetin POLIS, Universitetin Politeknik të Tiranës dhe shkollën “Harry Fultz”.

Përmes sesioneve edukative dhe bashkëpunimit ndërajonal, kampi krijoi mundësi për zgjerimin e njohurive, ndërtimin e kontakteve profesionale dhe nxitjen e një kulture që vlerëson kreativitetin dhe inovacionin.
Aktiviteti u përmbyll me ceremoninë e certifikimit të pjesëmarrësve, duke vlerësuar angazhimin e tyre dhe duke inkurajuar zhvillimin e mëtejshëm të ideve dhe projekteve inovative.

Regional IP Youth Camp konfirmoi rëndësinë e investimit te të rinjtë dhe e bashkëpunimit rajonal në ndërtimin e një të ardhmeje ku idetë krijuese mbrohen, zhvillohen dhe shndërrohen në vlera ekonomike e shoqërore.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Tetor 2026

DPPI zhvillon workshop informues me UNITA mbi mbrojtjen e pronësisë industriale





Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale zhvilloi një workshop informues në ambientet e UNITA-s, me fokus regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë industriale.

Gjatë takimit u trajtuan çështje që lidhen me regjistrimin e markave tregtare dhe treguesve gjeografikë, duke ofruar informacion praktik mbi mënyrat e mbrojtjes dhe promovimit të produkteve dhe identitetit të bizneseve.

Aktiviteti shërbeu si një hapësirë komunikimi dhe shkëmbimi përvojash me pjesëmarrësit, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e pronësisë industriale në forcimin e identitetit dhe vlerës së biznesit.

Ky takim ishte aktivitet që vjen pas marrëveshjes së nënshkruar 2 muaj më parë mes DPPI-së dhe UNITA.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Tetor 2026

Dy shqiptarë përfitojnë grante evropiane për edukimin në shkencë dhe inovacion

Znj. Marinela Barci dhe z. Klarens Hoxha janë përzgjedhur nga Rrjeti Evropian i Shpikësve (European Inventor Network – EIN) për të përfituar grante në vlerën 2,000 euro secili, për vitin 2027. Mbështetja nga Zyra Evropiane e Patentave (EPO) do të mundësojë zhvillimin e aktiviteteve edukative për nxitjen e interesit të fëmijëve dhe të rinjve ndaj shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Projektet e tyre fokusohen në elektronikën e avancuar dhe qarqet elektrike, si dhe në përdorimin praktik të energjisë së rinovueshme. Këto nisma synojnë të afrojë brezat e rinj me fushat STEM dhe të zhvillojnë kreativitetin, mendimin inovativ dhe kulturën sipërmarrëse.



Marinela Barci



From Simple Materials to Advanced Electronics

Place of implementation of activity: Albania

This activity received a grant of €2 000



Klarens Hoxha



Power Circuits and Renewable Energy Needs in Real Life

Place of implementation of activity: Albania

This activity received a grant of €2 000



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Tetor 2026

DPPI kontribuon në konferencën për transferimin e teknologjisë dhe inovacionin në universitete





Më 20 tetor 2026, në ambientet e Western Balkans University (WBU), u zhvillua konferenca ndërkombëtare “Bridging the Gap: Technology Transfer Hubs Connecting Tech2Link Western Balkans Universities, Business and Society”, në kuadër të projektit Tech2Link. Në këtë aktivitet, DPPI kontribuoi me prezantimin e temës “Registration of Innovation and Inventions in Albania”, duke vënë në fokus rëndësinë e regjistrimit dhe mbrojtjes së shpikjeve dhe inovacioneve. Konferenca mblodhi përfaqësues të universiteteve partnere nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Polonia, me synimin për të forcuar lidhjet ndërmjet kërkimit shkencor, universiteteve, biznesit dhe shoqërisë. Pjesëmarrja e DPPI-së kontribuon në ndërgjegjësimin mbi rolin e pronësisë industriale në transferimin e teknologjisë dhe komercializimin e inovacionit.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE


Tetor 2026

DPPI merr pjesë në eventin rajonal të EUIPO-s në Barcelonë



Në datat 22–23 tetor 2026, DPPI mori pjesë në aktivitetin rajonal “EUIPO & Barcelona FTZ Regional Event – From FTZs to Innovation Ecosystems: IP as a Driver of Competitiveness”, zhvilluar në Barcelonë, Spanjë, në kuadër të projektit EU4IP. Aktiviteti, i organizuar nga EUIPO në bashkëpunim me OECD-në dhe Barcelona Free Trade Zone, trajtoi rolin e pronësisë intelektuale në nxitjen e inovacionit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e ekosistemeve inovative. Pjesëmarrja e DPPI-së krijoi mundësi për shkëmbimin e praktikave të mira, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e bashkëpunimit rajonal, në përputhje me standardet evropiane në fushën e pronësisë intelektuale.





DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Tetor 2026



Njoftim për Workshop-in Rajonal Online mbi Shqyrtimin e Markave Tregtare



Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale njofton organizimin e Workshop-it Rajonal Online "Trade Mark Examination: Application of EUIPN Common Practices in Trade Mark Examination – from Absolute Grounds to Opposition Practice", i cili do të zhvillohet në datat 12–13 nëntor 2026, në kuadër të projektit EU4IP-WB. Aktiviteti do të mbledhë ekspertë të EUIPO-s dhe specialistë të zyrave të pronësisë industriale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, për të diskutuar praktikat e përbashkëta evropiane në shqyrtimin e markave tregtare. Temat kryesore përfshijnë shkaqet absolute dhe relative të refuzimit të regjistrimit, praktikën gjyqësore dhe raste konkrete nga praktika profesionale. Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë të interesuarit, të cilët mund të regjistrohen përmes platformës së përcaktuar nga organizatorët.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Tetor 2026



OPEN DAY – Takime dhe asistencë për krijuesit dhe sipërmarrësit

OPEN DAY – Takime dhe asistencë për krijuesit dhe sipërmarrësit
Gjatë muajit Tetor, në kuadër të rritjes së transparencës dhe ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, DPPI zhvilloi takime individuale me krijues, sipërmarrës, aplikantë dhe subjekte të interesuara për pronësinë industriale.
Vetëm për muajin tetor u zhvilluan 17 takime me krijues, sipërmarrës dhe përfaqësues të subjekteve.

Takimet synojnë të sjellin shërbimin më pranë qytetarëve dhe biznesit, përmes informimit, sqarimit të procedurave dhe asistencës konkrete për mbrojtjen e markave, shpikjeve, disenjove dhe krijimeve të tjera të pronësisë industriale.

Open Day do të vijojë të organizohet çdo muaj, si pjesë e angazhimit të DPPI për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit ndaj publikut.

Të interesuarit mund të kërkojnë takim duke dërguar kërkesën në **info@dppi.gov.al,** dhe specifikuar shkurtimisht çështjen për të cilën kërkojnë informacion apo asistencë.

Informacionet mbi datat dhe aktivitetet e Open Day publikohen gjithashtu në faqen zyrtare të DPPI-së, www.dppi.gov.al, si dhe në profilet zyrtare në rrjetet sociale:

Facebook – Dppi Albania
Instagram – @dppialbania.